REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr._____/2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të paragrafit të dytë, të pikës 3.3, të nenit 45, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"... Për kontrollin e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet afati i njoftimit, të parashikuar në nenin 81, të këtij ligji.".

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 88, pas fjalëve "... detyrimet tatimore të papaguara, ..." shtohen "... përfshirë parapagimet sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, ...".

Neni 3

Në nenin 120 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 120
"Pagesat ose arkëtimet me para në dorë mbi kufijtë e lejuar"."

2. Paragrafi i parë i nenit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Tatimpaguesit, personat fizikë, individët tregtarë dhe të vetëpunësuar apo entitetet, që kryejnë transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë, në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 59, të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 10 për qind të vlerës së secilit transaksion.".

Neni 4

Paragrafi i parë i nenit 126 numërtohet me numrin "1" dhe pas tij shtohen paragrafët me numrat "2" dhe "3", me këtë përmbajtje:

"2. Kur tatimpaguesi, pasi është dënuar, sipas paragrafit të parë, të këtij neni, refuzon ta japë informacionin edhe pas përsëritjes së kërkesës, ndaj tij zbatohen dispozitat e nenit 127, të këtij ligji.

3. Mosparaqitja e dokumentacionit të transferimit të çmimit, brenda afatit të përcaktuar në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", dënohet me gjobë 100 000 lekë.".

Neni 5

Në pikën 3, të nenit 127, pas fjalëve "... gjendjen e tij ekonomike-financiare, ..." shtohen fjalët "... ose kur tatimpaguesi, pasi është dënuar sipas nenit 126 të këtij ligji, refuzon të japë informacionin e kërkuar edhe pas përsëritjes së kërkesës, ...".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ